



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 9 dhjetor 2022
Nr.ref.: RK 2090/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI09/22

Parashtrues

Zef dhe Pal Gruda

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme PA-II.nr.5/2021, të 15 korrikut 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Zef dhe Pal Gruda nga Prizreni (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PA-II.nr.5/2021] të Gjykatës Supreme të Kosovës të 15 korrikut 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [APS.nr.43/2020] të 26 shkurtit 2021 të Gjykatës së Apelit – Departamenti Special (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).
3. Parashtruesit e kërkesës Aktgjykimin [PA-II.nr.5/2021] të 15 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme, e kanë pranuar më 17 shtator 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 1 të protokollit shtesë dhe 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 20 janar 2022, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në postë, e cila në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) arriti dhe u regjistrua më 25 janar 2022.
7. Më 3 shkurt 2022, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Remzie Istrefi Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 4 mars 2022, Gjykata e njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.
9. Më 4 mars 2022, Gjykata e njoftoi për regjistrimin e kërkesës Gjykatën Themelore në Prizren (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) dhe kërkoi nga ajo që të sjellë fletkthesën që dëshmon se kur parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme.
10. Më 25 mars 2022, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumente shtesë.
11. Më 13 qershor 2022, përfaqësuesi i parashtruesve të kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë së bashku me autorizimet për përfaqësim, dhe kërkoi nga Gjykata që ti

bashkojë kërkesat e parashtruara nga parashtruesit e kërkesës para gjykatës, përkatësisht me kërkesën KI16/21.

12. Më 16 nëntor 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë që ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

13. Bazuar në shkresat e lëndës, parashtruesit e kërkesës janë viktimat të fajdeve të cilët kishin marrë para në formë të fajdesh nga disa persona për të cilët ankohen se Gjykatat nuk kanë vendosur në mënyrë meritore.
14. Më 24 maj 2019, Gjykata Themelore përmes aktgjykimit [PKR.nr.76/2018] i kishte liruar nga akuza të akuzuarit si në vijim: Tune Kqira për veprën penale krimi i organizuar nga neni 274 par.3 te Kodit Penal te Kosovës (në tekstin e mëtejme:KPK), lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 267 par.2 e lidhur me nenin 23 te KPK-së, dhe veprën penale fajdeja nga neni 343 par.3 te KPRK-se, te akuzuarit Gjon Kqira dhe Marjan Kqira i ka liruar nga akuza për veprën penale krimi i organizuar nga neni 274 par.1 te KPK-se, lidhur me veprën penale detyrimi nga neni 267 par.2 te KPK-se, dhe veprën penale fajdeja nga neni 343 par.3 te KPRK lidhur me nenin 23 te KPK, te akuzuarit Kastriot Kqira, Benson Buza, Gjekson Kqira i ka liruar nga akuza për veprën penale krimi i organizuar nga neni 274 par. 1 te KPK, po ashtu te akuzuarit Tune Kqira, Kastriot Kqira, Benson Buza, Marjan Kqira dhe Gjon Kqira i ka liruar nga akuza për veprën penale shperlarje e parave nga neni 308 lidhur me nenin 31 te KPRK e lidhur me nenin 32 par.1 dhe 2 nënpar.2.1 të ligjit nr.03/L-96 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe mundësimin e terrorizmit. Ndërsa i ka shpallur fajtorë dhe iu ka shqiptuar dënimet si ne vijim: Te akuzuarin Kastriot Kqira për veprën penale detyrimi nga nenin 267 par.2 te KPRK dhe fajdeja nga neni 343 par.3 te KPRK-se, dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh ne te cilin i ka llogaritur edhe kohen e kaluar ne masën paraburgimit nga data 28.05.2015 gjer me date 11.10.2015, si dhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga nenin 374 par. 1 te KPRK-se, e qe e ka shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobe ne lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) €. Tune Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga nenin 300 par.3 lidhur me par.2 lidhur me nenin 32 e nenin 31 te KPRK-se, i ka shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 3 (tre) muaj dhe i ka llogaritur kohen e kaluar ne paraburgim nga data 28.05.2015 gjer me date 29.08.2017 dhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga nenin 374 par. 1 te KPRK-se, e ka shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobe ne lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) €. Gjon Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga nenin 300 par.3 lidhur me par.2 e lidhur me neni 31 te KPRK-se, i ka shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pese) muaj dhe i ka llogaritur kohen e kaluar . ne paraburgim nga data 25.05.2015 e gjere me date 11.10.2017, dhe për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par.1 te KPRK-se, e ka shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobe ne lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) €. Marjan Kqira për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga nenin 374 par. 1 te KPRK-se, e ka shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobe ne lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) €. Benson Buza për veprën penale detyrimi nga nenin 267 par.2 te KPK: se dhe fajdeja nga nenin 343 par.3 te KPRK-se, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pese) muaj ne te cilin i ka llogaritur edhe kohen e kaluar ne paraburgimin nga data 28.05.2015 e gjer me date 03.10.2015, si dhe për veprën penale mbajtja ne

pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga nenin 374 par. 1 të KPRK-se, e ka shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me gjobe në lartësi prej 1.500 (njëmijepesëqind) €, të cilin e ka obliguar që në afat prej 15 ditësh ta paguaj gjobën në të kundërtën dënimi do të zëvendësohet në dënim me burgim ku do të llogaritet për çdo 20 euro të gjobës me një ditë burgimi. Besfort Omaj për veprën penale detyrimi nga nenin 267 par.2 të KPRK-se, për të cilin i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 5 (pese) muaj të cilit i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim përkatësisht arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 gjer me date 30.06.2017. Gjeksion Kqira për veprën penale fajdeja nga neni 343 par. 1 të KPRK-se, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tete) muajve dhe dënim me gjobe në lartësi prej 1000 (njëmijë) €, në këtë dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 28.05.2015 gjer me date 26.01.2016. Gëzim Kqira për veprën penale fajdeja nga nenin 343 par. 1 të KPRK-se, i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashte) muajve dhe dënimin me gjobe në lartësi prej 1000 (njëmijë) €, në dënimin i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim nga data 11.10.2015 e gjer me date 09.02.2016. Dënimin me burgim me pëlqimin e të akuzuarit e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi prej 3.000 (tremijë) €, që të akuzuarin e ka detyruar që këtë shumë ta paguaj në afat prej 15 ditësh, e në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë të njëjtit do të zëvendësohet dënimi me gjobë në dënim me burgim duke i llogaritur për çdo 20 euro të gjobës me një ditë burgim. Gjykata e shkalles së parë, po ashtu ka urdhëruar shfuqizimin e aktvendimit të datës 11.02.2016, vendimet dhe urdhëresat e konfiskimit të pasurisë së pa luajtshme dhe të luajtshme duke urdhëruar kthimin e këtyre sendeve tek të akuzuarit që ju kanë sekuestruar të përshkruar si në dispozitiv, ndërsa ka urdhëruar konfiskimin e armeve ndaj të akuzuarve Tune, Marjan, Kastriot, Gjon Kqira dhe Benson Buza. Të dëmtuarit i ka udhëzuar që kërkesat pasurore juridike të realizojnë në procedurë kontestimore. I ka obliguar secilin të akuzuar veç e veç që të paguajnë shumën prej 2.000 (dymijë) €, në emër të paushallit gjyqësor - si shpenzime të procedurës penale dhe po ashtu se cilin veç e veç të paguaj shpenzimet prej 50 €, në emër të shpenzimeve të procedurës penale për fondin për kompensimin e viktimave të krimit.

15. Në një datë të pasaktësuar, Prokuroria e shtetit parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
16. Më 4 maj 2020, Gjykata e Apelit përmes aktgjykimit [APS.nr.06/2019] aprovon ankesën e Prokurorisë dhe sipas detyrës zyrtare e ndryshon pjesërisht aktgjykimin e ankimuar në pjesën liruese ashtu që i shpall fajtor të akuzuarit: Tune Kqira, Kastriot Kqira, Gjon Kqira, Marjan Kqira, Benson Buza, Gjeksion Kqira, Gëzim Kqira, për veprën penale detyrimi nga nenin 328 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-se dhe për veprën penale fajdeja nga neni 343 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-se, duke i gjykuar si: Tune Kqira me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pese) vite dhe dënim me gjobë në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) €, Kastriot Kqira me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pese) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) €, Gjon Kqira me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vjet e 6 (gjashte) muaj dhe dënim me gjobe në shumën prej 10.000 (dhjetëmijë) €, Marjan Kqira me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, Benson Buza me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pese) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 20.000 (njëzetmijë) €, Gjeksion Kqira me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, dhe Gëzim Kqira me dënim burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) euro. Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë e ndryshon pjesërisht aktgjykimin e shkalles së parë, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarit Besfort Omaj për veprën penale detyrimi nga nenin 267 par.2 të KPRK-se, e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pese) vite, në të cilin dënimin i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim. Tune

Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.3 lidhur me , par.2 të KPRK-se, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tete) muaj. Gjon Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 300 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-se, e gjykon me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tete) muaj. Ndërsa të akuzuarit: Tune Kqira, Gjon Kqira, Benson Buza, Marjan Kqira dhe Kastriot Kqira, për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.2 të KPRK-se, për të cilën janë shpallur fajtor e ndryshon aktgjykimin, ashtu që secilit të akuzuar iu shqipton dënimin me gjobe në shumën prej nga 5.000 (pesëmijë) €. Në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së, të akuzuarve ju shqiptua dënimi unik si në vijim: Tune Kqira me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 7 (shtate) vite, dhe dënim me gjobe në shumë prej 25.000 (njëzetepesëmijë) €, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, Kastriot Kqira me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (Pese) vite, dhe dënim me gjobe në shumë prej 25.000 (njëzetepesëmijë) €, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Gjon Kqira me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (pese) vite e 6 (gjashte) muaj, dhe dënim me gjobe në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Marjan Kqira me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite, dhe dënim me gjobe në shumë prej 10.000 (dhjetëmijë) €, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Benson Buza me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 5 (Pese) vite, dhe dënim me gjobe në shumë prej 25.000 (njëzetepesëmijë) €, në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim. Gjykata e Apelit , e anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rigjykim dhe rivendosje vetëm sa i përket veprës penale shpëlarjes së parave si në pikën II të diapozitivit dhe pjesës së konfiskimit të pasurisë. Mbetet në fuqi aktvendimi i datës 11.02.2016 dhe urdhëresat për sekuestrimin e pasurisë mbesin edhe me tutje në fuqi. Po ashtu, Gjykata e Apelit të akuzuarve: Tune Kqira, Kastriot Kqira, Gjon Kqira Benson Buza dhe Besfort Omaj, u caktoi masën e paraburgimit e cila mase do t'iu llogaritet nga data e arrestimit, por jo me gjatë se dënimet e shqiptuara me aktgjykimin.

17. Në një datë të pasaktësuar të akuzuarit kishin paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme.
18. Më 8 nëntor 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [PA-II.nr.2/2020] me miratimin e ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve Tune Kqira, Gjon Kqira, Marjan Kqira dhe Gëzim Kqira, e sipas detyrës zyrtare në raport me të akuzuarit Kastriot Kqira, Benson Buza, Gjeksion Kqira dhe Besfort Omaj, e ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit APS.nr.6/2019 të datës 4 maj 2020, dhe çështjen ia ka kthyer në rivendosje kësaj gjykate. Ankesa e të akuzuarit Besfort Omaj, e shpalli jo lëndore. Ndaj të akuzuarve Tune Kqira, Kastriot Kqira, Gjon Kqira, Benson Buza dhe Besfort Omaj, vazhdohet paraburgimi i caktuar me aktvendimin APS.nr.06/2019 të datës 4 majit 2020.
19. Më 26 shkurt 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS.nr.43/2020] në procedurën e rivendosjes e kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren PKR.nr.76/2018 të 24 majit 2019, ashtu që të akuzuarit: Tune Kqira, Gjon Kqira, Marjan Kqira, Benson Buza, Gjeksion Kqira, Gëzim Kqira, i ka shpallur fajtor për veprën penale fajdeja nga neni 343 par.3 lidhur me par.1 si në pikat 1/1, 1/3 , 1/4, 1/8,1/9, 1/11, 1/12, 1/13, e 1/14 në bashkim me veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 lidhur me par.1 si në pikat 1/1, 1/2, 1/3, 1/4, 1/5, 1/6, 1/7 e 1/9, në bashkëryerje nga neni 31 e lidhur me nenin 81 në vazhdimësi të KPRK, ashtu që gjykata i caktoi dënimet për veprën penale fajdeja nga neni 343 par.3 lidhur me par.1 si në pikat e lartcekura. Të akuzuarit: Tune Kqira, dënim burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 10.000 (dhjetëmijë) €, Kastriot Kqira, dënim burgimi në kohëzgjatja prej 4 (katër) vite dhe me gjobe në lartësi prej 10.000

(dhjetëmijë) €, Gjon Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatja prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 3.000 (tremijë) €, Marjan Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatja prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 3.000 (tremijë) €, Benson Buza, dënim burgimi ne kohëzgjatja prej 3 (tri) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 10.000 (dhjetëmijë) €, Gjeksion Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 3.000 (tremijë) €, Gëzim Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 3.000 (tremijë) €. Për veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 lidhur me par. 1 te KPRK-se, si ne pikat e lartcekura: Te akuzuarit: Tune Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobe ne shume prej 10.000 (dhjetëmijë) €, Kastriot Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 10.000 (dhjeternije) €, Gjon Kqira, dënim burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 5.000 (pesëmijë) €, Marjan Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatja prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 2.000 (dy mijë) €, Benson Buza, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 10.000 (dhjetëmijë) €, Gjeksion Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 2.000 (dy mijë) €, dhe Gëzim Kqira, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 2.000 (dy mijë) €. Me aprovimin e ankesës se Prokurorisë e ndryshon pjesërisht aktgjykimin e shkalles se pare, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu qe te akuzuarit Besfort Omaj për veprën penale detyrimi nga nenin 267 par.2 te KPK-se, e gjykon me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 5 (pese) vite, ne te cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim. Tune Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga nenin 300 par.3 lidhur me par.2 te KPRK-se, e gjykon me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tete) muaj. Gjon Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga nenin 300 par.3 lidhur me par.2 te KPRK-se, e gjykon me dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 8 (tete) muaj. Ndërsa te akuzuarit Tune Kqira, Gjon Kqira, Benson Buza, Marijan Kqira dhe Kastriot Kqira, për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga nenin 374 par.2 te KPRK-se, për te cilën janë shpallur fajtor e ndryshon aktgjykimin, ashtu qe secilit te akuzuar iu shqipton dënimin me gjobe ne shumen prej nga 5.000 (pesëmijë) €. Në mbështetje të nenit 80 te KPRK-se, te akuzuarve iu shqipton dënimin unik me burgim: Tune Kqira dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 7 (shtate) vitesh dhe dënim me gjobë në shumë prej 25.000 (njëzetepesëmijë) €, Kastriot Kqira, dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 5 (Pese) vitesh dhe dënim me gjobe ne lartësi prej 25.000 (njëzetepesëmijë) €, Gjon Kqira, dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 5 (pese) vite e 6 (gjashte) muaj dhe me gjobe ne lartësi prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €, Marjan Kqira, dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobe ne lartësi prej 10.000 (dhjetëmijë) €, Benson Buza, dënim burgimi ne kohëzgjatje prej 5 (Pese) vite dhe dënim me gjobe ne lartësi prej 25.000 (njëzetepesëmijë) €, Gjeksion Kqira, dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobe ne lartësi prej 5.000 (pesëmijë) €, Gëzim Kqira, dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe me gjobe ne lartësi prej 3.000 (tremijë) €. Ne rast se te akuzuarit nuk i paguajnë dënimet me gjobe ne afat prej 3 muajsh, dënimet me gjobe ndaj secilit te akuzuar do te zëvendësohen me dënim me burgim ku secilit te akuzuar për dënimin e shqiptuar do ti llogaritet për një dite burgim me 20 € te gjobës. I ka obliguar te akuzuarit qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale te paguajnë secili veç e veç shumen prej 2.000 (dymijë) €, si dhe ne emër te kompensimit te viktimave krimin secili veç e veç shumen prej 50 €. Vendimi lidhur me dënimin plotësues për konfiskimin mbetet i pandryshuar. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike janë udhëzuar ne kontest civil. Janë refuzuar si te pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve.

20. Në një datë të pasaktësuar, përfaqësuesit e të akuzuarve Tunë Kqira, Gjon, Marjan, Gëzim Kqira, i akuzuari Besfort Omaj, kishin parashtruar ankesë në Gjykatën

Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [APS.nr.43/2020] të 26 shkurtit 2021, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar ose jo të plote të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të shpallen të pafajshëm ose lënda të kthehet në rigjykim, dhe t'iu ndërpritet masa e paraburgimit.

21. Ankesë po ashtu kishin parashtruar edhe parashtruesit e kërkesës përmes përfaqësuesve ligjor të tyre, për shkak të vendimit për kërkesën pasurore-juridike, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet sa i përket kërkesës pasurore juridike, duke e gjykuar kërkesën pasurore juridike për shumën e cekura në pikën 1, 2, 3, 4 dhe 5 të aktgjykimit, apo lidhur me këto baza atakuuese aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.
22. Më 28 prill 2021, Prokurori i Shtetit përmes shkresës PPA-III-nr.8/2021 kishte propozuar që të refuzohen si të pabazuara ankesat e paraqitura nga mbrojtësit e të akuzuarve dhe përfaqësuesve të autorizuar të palëve të dëmtuara.
23. Më 15 korrik 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PA-II.nr.5/2021] vendosi si në vijim: (i) Me aprovimin e pjesëshëm të ankesave të mbrojtësve të të akuzuarve: Tune Kqira, Gjon Kqira, Marjan Kqira, Gëzim Kqira, e sipas detyrës zyrtare edhe në raport me të akuzuarit: Kastriot Kqira, Benson Buza dhe Gjekson Kqira, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special APS.nr.4312020 i datës 26.02.2021, përkitazi me disa pika të dispozitivit të aktgjykimit për veprën penale të fajdes nga neni 343 par.3 lidhur me par.1 të KPRK dhe veprës penale detyrimi nga neni 340 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK, për të cilat pika në pajtim me nenin 364 pika 1.3 të KPPK, të akuzuarit lirohen nga akuza sepse, nuk ka prova se i kanë ndërmarrë veprimet inkriminuese; (ii) me aprovimin e ankesave të mbrojtësve të akuzuarve: Tune Kqira, Gjon Kqira, Marjan Kqira, Gëzim Kqira dhe sipas detyrës zyrtare edhe në raport me të akuzuarit: Kastriot Kqira, Benson Buza dhe Gjekson Kqira sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i lartcekur ndryshohet edhe sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që të akuzuarve iu caktoi dënimet si në vijim: Për veprën penale fajdeja nga neni 343 par.3 lidhur me par.1 të KPRK: -Tune Kqira, sipas pikës 1.9 dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, - Kastriot Kqira, sipas pikave 1.3,14,1.9 të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, - Gjon Kqira, sipas pikave 1.11 dhe 1.12 të dispozitivit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënimin me gjobe në shumë prej 1.500 (njëmijepesëqind) €, - Marjan Kqira, sipas pikës 1.9 të dispozitivit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobe në shumën prej 1.500 (njëmijepesëqind) €, -Benson Buza, sipas pikave 1.1 dhe 1.10 të dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, - Gjekson Kqira, sipas pikave 1.8 dhe 1.14 të dispozitivit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobe në shumën prej 1.500 (njëmijepesëqind) €, - Gëzim Kqira, sipas pikave 1.3 të dispozitivit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobe në shumën prej 1.500 (njëmijepesëqind) €. Për veprën penale detyrimi nga neni 340 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK: të akuzuarit: -Tune Kqira, sipas pikave 1.7,1.9 të dispozitivit, dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, - Kastriot Kqira, sipas pikave 1.2,1.3,1.4,1.5,1.6,1.7, të dispozitivit dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe dënim me gjobe në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €, - Gjon Kqira, sipas pikave 1.7,1.9, të dispozitivit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me gjobe në shumë prej 2.500 (dymijepesëqind) €, - Marjan Kqira, sipas pikave 1.71.1.9, të dispozitivit, dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me gjobe në shumë prej 1.000 (njëmijë) €, - Benson Buza sipas

pikës 1.2, te dispozitivit, dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 2 (dy) vite dhe me gjobe ne shume prej 5.000 (pese mije) E, - Gjekson Kqira, sipas pikës 1.7, te dispozitivit , dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me gjobe ne shume prej 1.000 (njëmijë) E, - Gëzim Kqira, sipas pikës 1.7, te dispozitivit, dënimin me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me gjobe ne shume prej 1.000 (njëmijë) E, 3. Te akuzuarve Tune Kqira e Gjon Kqira për veprën penale organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit te paligjshëm nga nenin 300 par.3 lidhur me par.2 te KPRK-se dhe veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga nenin 374 par.2 te KPRK-se dënimet e shqiptuara secilit me burgim ne kohëzgjatje prej nga 2 (dy) vite e 8 (tete)muaj dhe me gjobe ne shume prej nga 5000€, dhe te akuzuarve Benson Buza, Marijan Kqira dhe Kastriot Kqira dënimet e shqiptuara me gjobe secilit ne shumen prej nga 5.000 (pesëmijë) E, për veprën penale mbajtja ne pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga nenin 374 par.2 te KPRK-se, ua merr si te vërtetuara. Kurse ne mbështetje te nenit 80 te Kodit Penal te Republikës se Kosovës, te akuzuarit i gjykon me dënim unik me burgim si ne vijim: -Tune Kqira, me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 5 (Pese) vite dhe dënim me gjobe ne shumen prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) E, ne këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 deri me date 29.08.2017; - Kastriot Kqira, me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 4 (katër) vite 6 (gjashte) muaj dhe dënim me gjobe ne shumen prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) E, ne këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 deri me datën 11.10.2017; - Gjon Kqira, me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 4 (katër) vite dhe dënim me gjobe ne shumen prej 10.500 (dhjetëmijepesëqind) E, ne këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 deri me date 11.10.2017; Marjan Kqira, me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 (tete) muaj dhe dënim me gjobë në shumën prej 7.500 (shtatë mijë e pesëqind) Euro, në dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 deri me date 12.06.2015 si dhe nga data 24.07.2015 e deri me date 11.10.2017; - Benson Buza, me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 3' (tri) vite 6 (gjashte) muaj dhe dënim me gjobe ne shumen prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €, ne këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 deri me datën 03.10.2017; - Gjekson Kqira, me dënim unik me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 (tete) muaj dhe dënim me gjobe ne shumen prej 2.500 (dymijepesëqind) €, ne këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 28.05.2015 deri me date 26.01.2016; - Gëzim Kqira, dënimi unik me burgim ne kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 (tete) muaj dhe dënim me gjobe ne shumen prej 2.500 (dymijepesëqind) €, ne dënim i llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim dhe arrest shtëpiak nga data 10.11.2015 deri me date 02.09.2016. Ne rast se te akuzuarit nuk i paguajnë dënimet me gjobe ne afat prej 3 (tre) muajsh, dënimet me gjobe ndaj : secilit te akuzuar do te zëvendësohen me dënim me burgim, ku secilit te akuzuar do ti llogaritet për 9do 20 €,te gjobës me një dite burgim; (iii) Ankesat e mbrojtësve te akuzuarve Tune Kqira, Gjon Kqira, Marjan Kqira, Gëzim Kqira, ne pjesët tjera refuzohen si te pabazuara; dhe (iv) ankesa e përfaqësuesve te autorizuar te palëve të dëmtuara Pal e Zef Gruda, dhe ajo e te akuzuarit Besfort Omaj hudhen si te palejuara.

Pretendimet e parashtresit të kërkesës

24. Parashtresit e kërkesës pretendojnë se me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 1 të protokollit shtesë [Mbrojtja e Pronës] dhe 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të KEDNJ-së.

25. Duke iu referuar pretendimit për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se “aktgjykimi i atakuar është tërësisht i paqartë dhe i pa kuptueshëm edhe për vetë profesionistët e fushës dhe lërë më për qytetarët e thjeshtë. Misioni dhe mbrojtja e të drejtës nuk nënkupton vetëm që në publik të lihet përshtypja se po bëhet drejtësi, por që gjykatat duhet të garantojnë dhe të bindin se drejtësia është bërë. Në rastin konkret Gjykata ka dështuar të provojë dhe të mbrojë një garancion të tillë, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i kuptueshëm dhe është tejet konfuz.”
26. Tutje parashtruesit e kërkesës pretendojnë se iu është shkelë parimi i barazisë së armëve për arsye se asnjëra nga ankesat e të akuzuarve drejtuar Gjykatës Supreme, nuk iu është dorëzuar këtyre si palë e dëmtuar për të dhënë përgjigje. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se “parimi i barazisë së armeve kërkon që secilës palë ti jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur rastin e saj, nën kushtet që nuk e vendosin atë në një pozite të pafavorshme vis - a - vis një palë tjetër. Edhe pse nuk ka asnjë përkufizim shterues se cilat janë kërkesat minimale të "barazisë së armeve" duhet të ketë garanci adekuate procedurale të përshtatshme për natyrën e rastit dhe që korrespondon me atë që është në pyetje ndërmjet palëve. Këtu mund të përfshihen mundësitë për të paraqitur fakte”.
27. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë aplikuar dispozitat ligjore në mënyrë të gabuar dhe arbitrare, dhe këtë iu kanë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Lidhur me këtë parashtruesit e kërkesës theksojnë se “aktgjykimi i atakuar me këtë kërkesë nuk ka marrë parasysh pretendimet e tona ankimore, të cilat Gjykata Supreme e Kosovës do të duhej të i kishte parasysh. Nuk me është gjykuar kërkesa pasurore juridike. Jemi udhëzuar në kontest civil. Me këtë veprim arbitrare, me aplikim të krejtësisht të njëanështet KPPRK, çka për pasojë ka pesë njëanshmërinë dhe shkeljen e të drejtave tona njerëzore e në veçanti edhe ato pronësore. Të akuzuarit janë privilegjuar ndërsa të drejtat tona janë shkelur e bashkë me to edhe gradacionet kushtetuese. Siç do të shiheni nga gjendja në shkresë, kjo çështje ka zgjatur shumë, jemi keqtrajtuar dhe kemi pas shpenzime edhe procedurale me angazhim të avokateve e të tjera, por edhe pse i kemi kërkuar shpenzimet, Gjykatat, e edhe Gjykata Supreme nuk na ka gjykuar dhe nuk ka dhënë asnjë arsyetim. Kur janë shpallur fajtor kryesisht e krimeve që ishin objekt i shqyrtimit edhe në Gjykatën Supreme, janë cekur shumat monetare sa na kanë marrë, zhvatur, posaçërisht për një pjesë të shumave materiale është cekur saktësisht dhe decidivisht shumat e zhvatura. Pse të udhëzoheshim në kontest civil, të nga shkaktohen përplasje në seri me këta persona, tani të zgjate procedura me decenie, e kur dihet afiniteti opstruktiv të kryesve të krimeve që janë gjykuar. Andaj, me na janë shkelur të drejtat tona nga neni 1. i Protokollit shtesë të Konventës Evropiane”.
28. Tutje parashtruesit e kërkesës theksojnë se “Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është një konfuzion dhe rrëmuje, i pa qartë, i pa arsyetuar në masë të duhet e posaçërisht me mangësi të arsyetimeve lidhur me ankesat tona. Në fazën e fundme edhe PSRK na ka bërë lëshime nga se edhe pse nuk kanë kaluar pretendimet akuzuese, nuk ka paraqitur ankese. Ankese në procedurën e me hershme ka paraqitur sa i përket kërkesës pasurore juridike, por ato pretendime ankimore Gjykata e apelit i ka injoruar. Andaj, edhe mangësia e arsyetimit të ankesës së PSRK dhe ankesave tona tere këtë procedure penale nga aspekti i palëve të dëmtuara e bene kundër kushtetuese, për çka lusim Gjykatën Kushtetuese që të aprovojë këtë kërkesë - ankese kushtetuese”.

29. Në fund parashtruesit e kërkesës nga Gjykata kërkojnë që: (i) të deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 30 dhe 31 të Kushtetutës dhe 1 të protokollit shtesë dhe 6 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin [PA-II.nr.5/2021] të 15 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme dhe aktgjykimet tjera të gjykatave të rregullta.

Dispozitat relevante të Kushtetutës Ligjit dhe Rregullores së punës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.”

[...]

Neni 30

[Të Drejtat e të Akuzuarit]

Çdokush që akuzohet për vepër penale, gëzon të drejtat minimale në vijim: (1) të njoftohet menjëherë në gjuhën që kupton, për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër saj/tij; (2) të njoftohet për të drejtat e tij/saj sipas ligjit; (3) të ketë kohë, mundësi dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; (4) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën në të cilën zhvillohet gjykimi; (5) të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikojë lirisht me të dhe, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, t'i sigurohet mbrojtja falas; (6) të mos shtrëngohet për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

(...)

NENI 1 Mbrojtja e pronës

*Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
(...)*

KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE

Neni 381 Personat e autorizuar për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimit

3. I dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.”

Rregullorja e punës

Rregulli 39
(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

*c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe
[...].”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, Gjykata vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar. Ndërsa, sipas paragrafit 7 i të njëjtin nen të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me Kushtetutë nga autoritet publike, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

31. Gjykata më tej i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj. Në lidhje me këtë, sipas paragrafit 1 të nenit 47 (Kërkesa individuale), çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik. Sipas paragrafit 2 të të njëjtit nen, individi mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
32. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesit e kërkesës janë palë të autorizuar, të cilët kontestojnë një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [PA-II.nr.5/2021] e 15 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
33. Megjithatë, Gjykata po ashtu thekson se sipas nenit 49 (Afatet) të Ligjit, kërkesa duhet parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Kjo kërkesë është përcaktuar edhe përmes pikës (c) të paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, që përcakton se kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajve nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
34. Në këtë kontekst, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [PA-II.nr.5/2021] të 15 korrikut 2021 të Gjykatës Supreme. Fletëkthesa e dorëzuar në Gjykatë nga Gjykata Themelore, vërteton që parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar aktin e kontestuar më 17 shtator 2021. Parashtruesit e kërkesës e kanë dorëzuar kërkesën e tyre në postë më 20 janar 2022 e cila në Gjykatë ka arritur më 25 janar 2022, më shumë se 4 muaj pas pranimit të aktit të kontestuar. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajve të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës, dhe rrjedhimisht është e papranueshme për shqyrtim.
35. Në rastet kur parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që kopja e vendimit të plotfuqishëm të organeve gjyqësore vendase t'i dorëzohet në mënyrë automatike, qëllimit dhe synimit të nenit 49 të Ligjit më së miri do t'i shërbejë nëse afati katërmujor llogaritet nga data kur është dorëzuar kopja e atij vendimi (shih, ndër të tjera, rastin GJEDNJ-së Worm kundër Austrisë, nr. 83/1996/702/894, aktgjykim i 29 gushtit 1997, paragrafi 33).
36. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI48/21, me parashtrues Xhavit R. Sadrija, Aktvendimi për papranueshmëri, i 30 qershorit 2021, paragrafi 44; dhe KI45/21, me parashtrues Samedin Bytyqi, Aktvendim për papranueshmëri, i 20 majit 2021, paragrafi 35; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-se Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 10865/09,45886/07 dhe 32431/08, të 17 shtatorit 2014, paragrafi 258).
37. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht, Gjykata nuk mund të shqyrtojë meritat e rastit, përkatësisht, nëse përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkelur të drejtat kushtetuese të parashtruesve të kërkesës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të neneve, 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 16 nëntor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- I. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- II. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani